

VENDIM
Nr. 182, datë 20.3.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE TË SIGURISË DHE ÇMIMIT TË
PULLAVE FISKALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 40, pika 1, e 42, të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e elementeve kryesore të pullave fiskale me sistem gjurmimi, si më poshtë vijon:

A) Karakteristikat e sigurisë:

a) Karakteristika të hapura: të dukshme me sy të lirë, përfshirë sfondet e sigurta me modele *Guilloche*, tekst të imët dhe efekte me ndryshim ngjyre. Karakteristikat e hapura përfshijnë elementet e mëposhtme:

- i. sfond i sigurt dhe tekst i imët: përdor modele *guilloche* dhe tekst të imët për verifikim të shpejtë;
- ii. kod 2D i dukshëm dhe kod i lexueshëm për njerëzit (HRC): kod barkod 2D i lexueshëm nga makinat dhe kod alfanumerik HRC për skanim dhe verifikim të lehtë;
- iii. efekt i ndryshimit të ngjyrës: karakteristika optike inovative me dy ndryshime të ngjyrës dhe veti polarizuese;
- iv. dëshmi për ndërhyrje: prerje mikro në materialin vetëngjitës për të parandaluar heqjen pa dëmtime;

b) Karakteristika gjysmë të fshehura: kërkojnë mjete të thjeshta për verifikim, si efektet e polarizimit dhe efektet UV. Karakteristikat gjysmë të fshehura përfshijnë elementet e mëposhtme:

- i. efektet e polarizimit: zbulohen duke përdorur një filtër polarizues;
- ii. efektet UV: efekt UV i gjelbër i dukshëm nën dritën UV;
- iii. siguria grafike e kodit 2D: verifikimi i kodit 2D përmes një aplikacioni celular për iOS dhe Android;

c) Karakteristika të fshehura: kërkojnë pajisje të specializuara për autenticitet, përfshirë kode të padukshme dhe substrakte të sigurta. Karakteristikat e fshehura përfshijnë elementet e mëposhtme:

- i. kod i padukshëm: kod unik, i padukshëm me barkod 2D që autentifikohet përmes pajisjeve të inspektimit;
 - ii. siguria digjitale e kodeve 2D: identifikues të enkriptuar për sistemin e gjurmimit dhe ndjekjes;
 - iii. substrakt i sigurt: materiale substrakte jokomerciale me karakteristika të sigurisë UV;
- ç) Karakteristika mjekoligjore: përmbajnë shenja të personalizuar që mund të autentifikohen vetëm në laboratorë të specializuar.

B) Karakteristikat e sigurisë digjitale:

a) Identifikuesi unik: çdo pullë fiskale përmban një identifikues shumë të sigurt dhe të koduar për sistemin e gjurmimit;

b) Kodet 2D: përfshijnë kode 2D të dukshme dhe të padukshme, të cilat përdoren për monitorimin e lëvizjes së produkteve dhe sigurimin e integritetit.

C) Kode të sigurta për industrinë e pijeve të ftohta:

- a) Alternativë ndaj pullave të sigurisë: kod unik 2D, i printuar gjatë procesit të prodhimit;
- b) Karakteristika të tjera: rezistente ndaj ndërhyrjeve nga sfondi dhe të verifikueshme nga konsumatorët dhe autoritetet përkatëse.

2. Çmimi i pullave fiskale është, si më poshtë vijon:

Produkti	Lloji i pullës fiskale	Çmimi për mijë copë në euro, (pa përfshirë taksat e tjera dhe TVSH-në)
----------	------------------------	---

Duhan	Pulla e akcizës	15.65 euro
Verë	Pulla e akcizës	25.04 euro
Birra	Kodi i sigurisë/pulla e akcizës	17.22 euro
Alkool	Kodi i sigurisë/pulla e akcizës	25.05 euro

3. Ngarkohen Ministria e Financave shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a., Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe shoqëria aksionare shtetërore “*Albtrace Co.*” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku